



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



KRYETARI I KRYEQYTETIT

14-030/01-126671/25 më 21 AUG 2025

Në bazë të dispozitave të nenit 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale dhe nenit 52 shkronja (n) të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit, merr këtë

V E N D I M

1. Miratohet Ndryshimi dhe plotësimi i Vendimit për organizimin, kompetencat, përgjegjësitë dhe sistematizimin e vendeve të punës së administratës komunale nr. 01-031-13761 i dt. 19.01.2016.
2. Sipas pikës 1 të këtij Vendimi, ndryshim - plotësimi nënkupton ndryshimin e nenit 22, paragrafi 22.19 të Vendimit, respektivisht bartjen e kompetencës për jepjen e lejes për përdorimin e objekteve të përfunduara (*certifikatës së përdorimit*) nga Drejtoria e Urbanizmit tek Drejtoria e Inspektionit.
3. Ky vendim është pjesë përbërëse e Vendimit për organizimin, kompetencat, përgjegjësitë dhe sistematizimin e vendeve të punës së administratës komunale nr. 01-031-13761 i dt. 19.01.2016.
4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohen të gjitha dispozitat e Vendimit nr. 01-031-13761 i dt. 19.01.2016 të cilat bien në kundërshtim me këtë Vendim.
5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

U DORËZOHET:

- Drejtorisë së Urbanizmit
- Drejtorisë së Inspektionit;
- Qendrës për shërbim me qytetarë;
- Në dosje.

KRYETARI I KRYEQYTETIT
Përparim Rama

